

-Një përshëndetje nga Pastor Ylli H. Doçi, President i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë

Tiranë, 11-12 Qershor 2019

Asnjërit prej nesh nuk do t'i pëlqente që parashikimet e Samuel Huntigton mbi "përplasjen e qytetërimeve" për shkak të besimeve fetare të vërtetoheshin pasi ne do të preferonim paqe dhe marrëdhënie sociale të mira mes çdo feje në botë, por duhet të jemi të sinqertë në të kuptuarit e realitetit në të cilin jetojmë dhe si rrjedhojë të mirëpresim diskutime kontraversiale të udhëhequra nga respekti dhe vërtetësia.

Politikanët kanë një rol ndryshe nga akademikët dhe sociologët në atë që ata mundën t'i vërtisin faktet dhe të shpërndajnë interpretime në drejtime të ndryshme teksa studentët e mirë të shoqërisë duhet të jenë trima përballë realitetit dhe ekspozimit të të vërtetave të fshehura, pa ndërë frikën e pasojave. E nënvizoj këtë nevojë për trimëri akademike sepse sot ka një tendencë drejt vetë-censurimit në mënyrë që të mos ofendohet askush në epokën e Twitter-it ku gjithçka mund të keqinterpretohet dhe keqpërdoret për të dëmtuar reputacione e shkatërruar karriera.

Kjo konferencë rajonale mbi rolin e fesë në shoqëri është e mirëpritur në Shqipëri, toka në të cilën komunitete të ndryshme fetare lulëzojnë në harmoni sociale me njëra-tjetrën. Unë përfaqësoj komunitetin fetar më të ri shqiptar, komunitetin Protestant Ungjillor, dhe dua t'ju theksoj se ky fakt i thjeshtë i ekzistencës në harmoni sociale me besimtarët e tjerë, teksa ne përfaqësojmë dukshëm komunitetin e të konvertuarve të lirë të popullsisë së tre feve ekzistuese në vendin tonë, është prove e një përqasjeje përgjithësisht tolerante midis shqiptarëve të besimeve të ndryshme të cilët njohin prioritetin social të bashkësisë si komb ndërkohë që ruhen prioritetet fetare, pa kërkuar hegjemoni fetare.

Në një pjesë të himnit kombëtar shqiptar, të cilën jo gjithmonë e këndojmë, thuhet: "Zoti vetë e tha me gojë, 'Kombet shuhën përmbi dhe, por, Shqipëria do të rrojë!' Për këtë luftojmë ne,". Këtu shohim një formë unike të konvergencës me fenë pasi edhe myslimanët, edhe të krishterët thonë njëzëri, "Ne i përkasim një kombi," teksa secili në kuptimin që i jep Zotit e konsideron këtë si vullnetin e tij, si të ishte duke u shprehur zë të plotë gjatë dëgjësës së tij! Do të ishte një diskutim vërtet interesant për t'u kryer ai i komplikimit të një uniteti të tillë kombëtar me diversitetin fetar, por ato rreshta arrijnë të shfaqin shpirtin e unitetit kombëtar shqiptar. Nuk mund të ketë një Shqipëri pa myslimanë dhe të krishterë bashkë, dhe si myslimanët ashtu edhe të krishterët e kanë mbajtur të bashkuar kombin shqiptar si një fakt të pafuzueshëm të historisë politike të më shumë se 100 viteve. Nëse kjo ndodh në Shqipëri, ka shpresë që mund të bëhet realitet edhe në shoqëritë e tjera, përfshirë këtu vendet fqinj të Ballkanit.

Harmonia sociale ndërfetare Shqiptare duhet eksploruar më tej, por në mënyrë që të ruhet ky bekim dhe të shumëfishohet një harmoni e tillë në çdo shoqëri pluraliste, çdo gjeneratë duhet të kryejë punën e saj të kultivimit të kulturës së tolerancës duke afirmuar barazinë e njerëzve me bindje të ndryshme fetare dhe identitete të bashkuara nga një vizion i përbashkët për një shoqëri demokratike me objektiva të qarta sociale. Kjo është arsyeja se pse puna e kësaj konference dhe të tjerave si kjo është e paçmueshme për të ardhmen e shoqërive tona. Ju falënderoj që keni sjellë kontributin tuaj në një kohë kaq të rëndësishme për botën tonë në mënyrë që të mund të shohim se si Huntigton ishte gabim në parashikimin e tij.